



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1516 prot.

Tiranë më 07.06.2024

URDHËR

Nr. 97, datë 07.06.2024

**PËR
PUBLIKIMIN E LISTËS SË DOKUMENTEVE EKZISTUESE QË OFROHEN
NË FORMATIN E TË DHËNAVE TË HAPURA**

Në mbështetje të nenit 7, të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

URDHËRON:

1. Publikimin në faqen zyrtare të institucionit, në Seksionin “Të dhënat e hapura dhe ripërdorimi i informacionit”, të listës së dokumenteve ekzistuese që ofrohen në formatin e të dhënave të hapura për qëllime ripërdorimi.
2. Kjo listë të përditësohet periodikisht me dokumente, që prodhohen nga strukturat përbërëse të institucionit, për qëllime ripërdorimi.
3. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Financës dhe Drejtoria e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit/Sektori për të Dhënat e Hapura dhe Konsultimin Publik, pranë KDIMDP-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi